

VENDIM
Nr. 200, datë 11.4.2018

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT
TË STATUSIT, NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË URBANE (TRUALL), PËR
NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË HIDROCENTRALIT “OSOJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, dhe të nenit 59, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të tokës, nga kategoria “tokë bujqësore” në “tokë urbane” (truall), për parcelën nr. 163/7, me sipërfaqe 1 054 (një mijë e pesëdhjetë e katër) m², në fshatin Osojë (ish-Komuna Moglicë), Bashkia Korçë, për ndërtimin e objekteve të hidrocentralit “Osojë”.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimin e kategorisë së pasurisë, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen 1 054 (një mijë e pesëdhjetë e katër) m², sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi